



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No.

01-060-01-35481-25

Nr. Fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date

17.11.2025

OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilič - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.10.10.2025, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Bajram Hashani, Labinot Mirena, Sami Ahmeti, Albana Shillova Shalaku dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal dhe përf.e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsytimi për mungesë
2. Shqyrtimi i kërkesës për ndarjen e mjeteve financiare për shujta për stafin shëndetësor në Obiliq
3. Shqyrtimi i kërkesave
4. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 5 vota për dhe 2 vota kundër.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën për ndarjen e mjeteve financiare për shujta për stafin shëndetësor në Obiliq.

Enver Gashi – Ne si grup jemi që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Ne votuam kundër për një arsyetim, e jo për shkakun që jemi kundër mirëqenies të secilit punëtor, ose secilit shërbëtor të Komunës por për faktin se kjo seancë ndoshta është sui generis në tërë Kosovën dhe është tentim në njëfarë mënyre të manipulimit të opinionit dhe atyre punëtorëve të stafit shëndetësor. Të kuptohemi jemi për, unë jam konsultuar edhe me Ministrinë e shëndetësisë, që kjo formë e paraqitjes së shujtës nuk kalon kështu që unë nuk dua të bëjë kamuflazhë. Do të thotë se ne jemi kundër kësaj forme për shkak se 2 ditë para zgjedhjeve, kjo kuptohet plotësisht për çka është dhe për këtë arsye ne do të votojmë kundër manipulimeve, do ta quajmë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës për ndarjen e mjeteve financiare për shujta për stafin shëndetësor në Obiliq.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga DEFZH-ja, për Raportin financiar të shpenzimeve Janar – Shtator 2025.
Enver Gashi – Ne si grup jemi për që Raporti financiar të shkoj në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Ne jemi kundër.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit Komunal si pikë e 3 e rendit të ditës raportin financiar të shpenzimeve Janar – Shtator 2025.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga DEFZH-ja, për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2025 dhe për alokimin e mjeteve në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale.

Enver Gashi - Ne jemi për që kjo kërkesë të shkoj për shqyrtim në Kuvend.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi, por kundër.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit Komunal si pikë e 4 e rendit të ditës shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DEFZH-ja, për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2025 dhe për alokimin e mjeteve në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën për pagesën e shujtave për anëtarët e SBASHK-ut, në sektorin e arsimit në Obiliq.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që edhe kjo kërkesë të shkoj në Kuvend për shqyrtim.

Sami Ahmeti – Ne jemi kundër për arsyen prej fillimit që e thashë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës për pagesën e shujtave për anëtarët e SBASHK-ut, në sektorin e arsimit në Obiliq.

Pika 4 e rendit të ditës


Kryesuesja - Meqë, nuk kemi diskutime në këtë pikë të rendit të ditës, atëherë e mbylli seancën.

Mbledhja përfundoi në ora 11:14 '

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuese e KPF


Vlora Mjekiçi Kabashi

